

## PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE :	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7 – 25

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Për drejtimin dhe aksionerët e Shoqërisë AIR BP Albania sh.a.**

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **AIR BP Albania sh.a.** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2017, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



**Diana Ylli (Golemi)**  
Auditues Ligjor



23 Mars 2018



Pasqyra e Pozicionit Financiar  
më 31 dhjetor 2017

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktivët afatgjatë</b>			
Aktivët afatgjatë materiale	5	153,401,465	167,800,987
<b>Totali i aktiveve afatgjatë</b>		<b>153,401,465</b>	<b>167,800,987</b>
<b>Aktivët afatshkurtra</b>			
Inventarë	6	166,630,955	54,981,615
Llogari të arkëtueshme tregtare	7	88,426,730	83,330,002
Tatim fitimi	22	61,425,741	5,917,027
Llogari të arkëtueshme të tjera	8	15,179,451	16,253,546
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	9	2,482,709	312,018
Mjetet monetare në arkë e në bankë	10	2,118,166,126	2,165,278,948
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>2,452,311,712</b>	<b>2,326,073,156</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>2,605,713,177</b>	<b>2,493,874,143</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali themeltar		30,000,000	30,000,000
Rezerva ligjore		3,000,000	3,000,000
Fitime të mbartura		2,448,536,799	2,025,184,697
Fitimi i ushtrimit		90,815,959	423,352,102
<b>Totali i kapitalit</b>	11	<b>2,572,352,758</b>	<b>2,481,536,799</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatgjatë</b>			
<b>Totali i detyrimeve afatgjatë</b>		-	-
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	12	31,195,340	9,993,273
Detyrime tatimore	13	679,392	708,222
Llogari të pagueshme të tjera	14	1,485,687	1,635,849
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>33,360,419</b>	<b>12,337,344</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>33,360,419</b>	<b>12,337,344</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>2,605,713,177</b>	<b>2,493,874,143</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga shitja	15	1,456,942,195	1,256,329,621
Kosto e prodhimit /blerjes së mallrave të shitura	16	(821,501,175)	(606,251,193)
<b>Fitimi (Humbja) bruto</b>		<b>635,441,020</b>	<b>650,078,428</b>
Shpenzimet e shitjes	17	(163,046,832)	(135,503,707)
Shpenzime administrative	18	(78,269,271)	(57,942,662)
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	19	466,855	204,266
Shpenzime të tjera të zakonshme	20	(2,401,313)	(6,516,100)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>392,190,459</b>	<b>450,320,225</b>
Të ardhurat/shpenzime financiare nga njesitë e kontrolluara		-	-
Të ardhura/(Shpenzime) financiare neto	21	(283,637,207)	50,534,892
<b>Total shpenzime financiare</b>		<b>(283,637,207)</b>	<b>50,534,892</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>108,553,252</b>	<b>500,855,117</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	22	(17,737,293)	(77,503,015)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>90,815,959</b>	<b>423,352,102</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>			
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>90,815,959</b>	<b>423,352,102</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**AIR BP Albania sh.a**  
(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Fitime të mbartura / humbje të akumuluar	Fitim / (Humbje) Ushtrimit	Totali
<b>Pozicioni financiar më 1 janar 2016</b>	30,000,000	3,000,000	1,555,722,225	469,462,472	2,058,184,697
Transferim në fitime të mbartura			469,462,472	(469,462,472)	-
Dividendë të paguar					-
Fitimi i vitit				423,352,102	423,352,102
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016</b>	<b>30,000,000</b>	<b>3,000,000</b>	<b>2,025,184,697</b>	<b>423,352,102</b>	<b>2,481,536,799</b>
Transferim në fitime të mbartura			423,352,102	(423,352,102)	-
Dividendë të paguar					-
Fitimi i vitit				90,815,959	90,815,959
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017</b>	<b>30,000,000</b>	<b>3,000,000</b>	<b>2,448,536,799</b>	<b>90,815,959</b>	<b>2,572,352,758</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Administratori më \_\_\_ mars 2018 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

*Alma Biraci*

Znj. Alma Biraci  
Hartues i Pasqyrave Financiare

*Z. Izet Loloci*  
Administrator  
**AIR BP ALBANIA Sh.A**



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
<b>Fitimi para tatimit</b>	108,553,252	500,855,117
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi	21,606,060	25,088,881
Rimarrje tatim i shtyrë	-	228,441
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>		
Rënie/(rritje) në inventar	(111,649,340)	37,563,163
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(10,481,238)	(10,928,531)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	21,023,075	225,997
Rënie/(rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra	(2,170,691)	294,373
<b>Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>	<b>26,881,118</b>	<b>553,327,441</b>
<b>Interesa të paguara</b>		
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(66,787,402)	(105,715,181)
	<b>(66,787,402)</b>	<b>(105,715,181)</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(7,206,538)	(4,744,802)
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues</b>	<b>(7,206,538)</b>	<b>(4,744,802)</b>
<b>Aktivitetet financuese</b>		
Dividendë të paguar		
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Ndryshimi neto i mjeteve monetare</b>	<b>(47,112,823)</b>	<b>442,867,458</b>
Mjetet monetare në fillim të periudhës	2,165,278,948	1,722,411,490
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>2,118,166,126</b>	<b>2,165,278,948</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 25, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## 1. Informacion i përgjithshëm

AIR BP Albania sh.a. është krijuar më 25.10.1999 me vendim gjykatë Nr. 9185 datë 04.11.1999. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe nga statuti i saj.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është tregtimi me shumicë i lëndëve djegëse për mjetet e fluturimit ajror reaktive si dhe i karburantëve për avionë dhe mjete motorike .

Shoqëria është regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatim-Paguesve të Mëdhenj Tiranë me NIPT J92302002L . Selia e Shoqërisë ndodhet në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Rinas.

Kapitali i shoqërisë është 30,000,000 Lekë dhe zotërohet 100% nga BP Holdings International B.V.

Administratori i Shoqërisë është Z.Izet Loloçi.

## 2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

### 2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet, amendimet dhe interpretimet në vijim, hyjnë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë në 1 janar 2017 ose pas kësaj date:

- Përmirësimet vjetore të SNRF (Cikli 2014 - 2016): SNRF 12 Shpalosjen e interesave në njësi të tjera
- SNK 12 Tatimi mbi të ardhurat (Amendim – Njohja e taksës së shtyrë si asset për humbje të porealizuara)
- SNK 7 Pasqyra e Flukseve Monetare (Shpalosjen e Amendimeve fillestare)

Nuk ka patur standarde apo interpretime të reja, të cilat kanë hyrë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë nga 1 janari 2017 ose pas kësaj date, që të kenë efekt të qenësishëm në pasqyrat financiare të kompanisë.

### 2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël të cilat behën efektive në periudhat e ardhshme kontabël dhe që kompania nuk ka vendosur ti përvetësojë më shpejt. Më të rëndësishmet janë:

- **SNRF 9 Blerësit e instrumentave financiare** (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 janari 2018 ose pas kësaj date)
- **SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me blerësit** (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 janari 2018 ose pas kësaj date); dhe
- **SNRF 16 Qiratë** (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 janari 2019 ose pas kësaj date)

Kompania nuk parashikon standarde të tjerë të publikuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël, që nuk janë në përdorim, të kenë ndikim material në pasqyrat financiare.

- **KIRFN 22 Përkthimin e Monedhave të huaja dhe Vlerësimin në Avancë (në fuqi më 1 janar 2018)**
- **Amendime të klasifikimeve të SNRF 2 dhe Matja e Transaksioneve me Pagesë Aksionesh (në fuqi më 1 janar 2018)**
- **Amendime të SNRF 4: Aplikimi i SNRF 9 Instrumentet Financiar me IFRS 4 Kontratat e Sigurimit (në fuqi më 1 Janar 2018)**
- **Amendime të SNA 40: Transfertat e Pasurive Investuese (në fuqi më 1 janar 2018)**
- **Përmirësime vjetore të Standardeve SNRF, cikli 2014 – 2016, që ndeshet me çështjet e SNRF 1 për herë të parë**



**2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)**

**2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara (vazhdim)**

- *Adoptimi dhe SNA 28 Investime në Ortakëri dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (në fuqi më 1 janar 2018)*
- *KIRFN 23 Paqartësi mbi Pozicionin e Taksës mbi të Ardhurat (hyn në fuqi më 1 janar 2019)*
- *Amendime të SNRF 9 Karakteristikat e Parapagimeve me Kompensim Negativ (hyn në fuqi më 1 janar 2019)*
- *Amendime të SNA 28: Interesat Afatgjatë në Ortakëri dhe Ndërmarrje të Përbashkëta (hyn në fuqi më 1 janar 2019)*
- *SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (hyn në fuqi më 1 janar 2021)*
- Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të këtë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre

**3. Bazat e përgatitjes**

**3.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-se.

**3.2. Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

**3.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

**3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

**3.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përkrahur më poshtë:

**3. Bazat e përgatitjes (vazhdim)****3.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)****3.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

**3.5.2. Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

**3.5.3. Zhvlerësimi i inventarëve**

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera , me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit , bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme . Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto , ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar . Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

**4. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

**4.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
EUR/Lek	132.95	135.23
USD/ Lek	111.10	128.17



#### 4. Politikat Kontabël

##### 4.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

##### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.



#### 4. Politikat Kontabël (vazhdim)

##### 4.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

###### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### 4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën FIFO (dalja e parë hyrja e parë) . Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

##### 4.4. Aktive afatgjata materiale

###### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

###### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

###### *iii. Amortizimi*

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur.

Amortizimi njihet në bazë të vlerës së mbetur, duke përdorur normat e përcaktuara nga manxhimi.



#### 4. Politikat Kontabël (vazhdim)

##### 4.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Vlera e mbartur e aktiveve afatgjata materiale rishikohen për zhvlerësim kur ngjarje apo ndryshime në rrethanat tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, kur vlera kontabël tejkalon vlerën e rikuperueshme të vlerësuar aktivet paraqiten me vlerën e tyre të rikuperueshme, e cila është më e larta mes vlerës së tyre të drejtë minus kostot për shitje dhe vlerës së tyre në përdorim.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo date raportimi dhe ndryshohen në rast se efektet janë materiale.

##### iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

##### 4.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

##### 4.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

##### 4.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

##### 4.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.



#### 4. Politikat Kontabël (vazhdim)

##### 4.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

##### 4.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

##### 4.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

##### 4.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

##### 4.13. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



AIR BP Albania sh.a  
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017  
(Vlerat janë në Lek)

5. Aktivet afatgjata materiale

Aktivt afatgjata materiale përbëhen si më poshtë :

<i>Kosto</i>	Ndertesa	Makineri e pajisje	Pajisje zyre	Pajisje informatike	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Gjendja më 1 janar 2016	121,856,710	156,522,695	2,555,870	7,328,089	76,741,015	3,640,894	368,645,273
Shtesa	1,741,128	1,772,670	382,366	721,888		126,750	4,744,802
Transferime							-
Pakësime							-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>123,597,838</b>	<b>158,295,365</b>	<b>2,938,236</b>	<b>8,049,977</b>	<b>76,741,015</b>	<b>3,767,644</b>	<b>373,390,075</b>
Shtesa		6,275,933	107,634	814,128		8,843	7,206,538
Transferime							-
Pakësime							-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>123,597,838</b>	<b>164,571,298</b>	<b>3,045,870</b>	<b>8,864,105</b>	<b>76,741,015</b>	<b>3,776,487</b>	<b>380,596,613</b>
<i>Amortizimi i akumuluar</i>							
Gjendja më 1 janar 2016	33,247,207	117,251,898	1,430,116	5,123,696	21,700,328	1,746,962	180,500,207
Amortizimi i vitit	5,825,299	7,215,459	76,526	574,453	11,008,138	389,006	25,088,881
Pakësime							-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2016</b>	<b>39,072,506</b>	<b>124,467,357</b>	<b>1,506,642</b>	<b>5,698,149</b>	<b>32,708,466</b>	<b>2,135,968</b>	<b>205,589,088</b>
Amortizimi i vitit	7,948,262	3,762,446	438,780	315,539	8,818,065	322,968	21,606,060
Pakësime							-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>47,020,768</b>	<b>128,229,803</b>	<b>1,945,422</b>	<b>6,013,688</b>	<b>41,526,531</b>	<b>2,458,936</b>	<b>227,195,148</b>
<i>Vlera neto kontabël</i>							
Gjendja më 31 dhjetor 2016	84,525,332	33,828,008	1,431,594	2,351,828	44,032,549	1,631,676	167,800,987
Gjendja më 31 dhjetor 2017	76,577,070	36,341,495	1,100,448	2,850,417	35,214,484	1,317,551	153,401,465

**6. Inventari**

Në këtë zë janë përfshirë mallrat, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mallra	166,630,955	54,981,615
	<u>166,630,955</u>	<u>54,981,615</u>

**7. Llogari të arkëtueshme tregtare**

Balanca e llogarive të arkëtueshme tregtare të shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Klientë vendas	7,432,728	4,659,464
Klientë të huaj	85,628,471	83,305,007
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(4,634,469)	(4,634,469)
	<u>88,426,730</u>	<u>83,330,002</u>

Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Gjendja me 1 janar	(4,634,469)	(4,634,469)
Zhvlerësimi për vitin	-	-
Rimarje për vitin	-	-
Gjendja më 31 dhjetor	<u>(4,634,469)</u>	<u>(4,634,469)</u>

**8. Llogari të arkëtueshme të tjera**

Gjendja e llogarive të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
TVSH për t'u marrë nga tatimet	15,179,451	16,253,546
	<u>15,179,451</u>	<u>16,253,546</u>

**9. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Parapagime për doganën	2,482,709	312,018
	<u>2,482,709</u>	<u>312,018</u>

**10. Mjete monetare**

Balanca e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare në Lek	21,780,090	2,806,403
Banka	21,615,910	2,735,166
Arka	164,180	71,237
Mjete monetare në valutë	<u>2,096,386,036</u>	<u>2,162,472,545</u>
Banka	2,095,621,754	2,162,362,405
Arka	764,282	110,140
	<u><u>2,118,166,126</u></u>	<u><u>2,165,278,948</u></u>

**11. Kapitali**

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është 30,000,000 Lekë dhe zotërohet 100% nga BP Holdings International B.V.

Rezervat ligjore më 31 dhjetor 2017 janë në vlerën 3,000,000 Lekë.

Fitim/(Humbjet) e mbartura më 31 dhjetor 2017 janë vlerën 2,448,536,799 Lekë.

**12. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Furnitor vendas	11,073,512	9,283,325
Furnitor të huaj	20,084,828	672,949
Furnitorë për fatura të pambërritura	37,000	36,999
	<u>31,195,340</u>	<u>9,993,273</u>

**13. Detyrimet tatimore**

Detyrimet tatimore të kompanisë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 vijojnë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	356,448	364,267
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	302,509	334,673
Tatim fitimi	-	-
Tatim në burim	20,435	9,282
	<u>679,392</u>	<u>708,222</u>



**14. Llogari të pagueshme të tjera**

Llogaritë e tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Detyrime të tjera ndaj të tretëve	1,485,687	1,635,849
	<u>1,485,687</u>	<u>1,635,849</u>

**15. Të ardhura nga shitja**

Të ardhurat nga shitja për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga shitja e mallrave	1,451,098,480	1,251,776,809
Të ardhura nga shërbime	5,843,715	4,552,812
	<u>1,456,942,195</u>	<u>1,256,329,621</u>

Rakordimi i të ardhurave me FDP-të:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Qarkullim i tatueshëm	1,477,641,569
Zbriten autofaturimet 2017	(20,699,374)
<b>Shuma e qarkullimit e korrektuar</b>	1,456,942,195
Sipas Kontabilitetit	1,456,942,195
<b>Diferenca</b>	<u>-</u>

**16. Kosto e blerjes së mallrave të shitura**

Kosto e mallrave të shitura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Kosto e mallrave të shitur	771,060,481	574,914,221
Transport në blerje	39,244,393	28,159,711
Taksa doganore dhe të tjera	11,196,301	3,177,261
	<u>821,501,175</u>	<u>606,251,193</u>



**17. Shpenzimet e shitjes**

Shpenzimet e shitjes së mallrave për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë :

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Komisione TAP	21,008,328	25,270,152
Komisione Shitje	26,684,448	-
Pagat e personelit	13,478,290	12,464,438
Sigurimet shoqërore	1,338,528	1,261,879
Kosto personeli nga jashtë	1,098,997	632,266
Karburant	3,738,801	2,853,242
Shpenzime riparimi mjete	1,046,027	898,498
Testim i mallrave të blera	3,232,740	2,889,422
Kontroll teknik i paisjeve	498,670	530,647
Qira Magazinimi	31,329,527	30,703,013
Mirëmbajtje dhe riparime te ndryshme	219,345	604,652
Uniforma e punonjesve	339,691	252,998
Sigurim kontrate	1,165,572	1,080,366
Transport i brëndshëm	32,989,065	28,095,148
Pjesa e amortizimit të paisjeve	20,528,773	23,857,877
Taksa lokale	4,350,030	4,109,109
	<u><b>163,046,832</b></u>	<u><b>135,503,707</b></u>

**18. Shpenzime administrative**

Shpenzimet administrative për vitin 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Pagat e personelit	17,924,297	18,254,862
Sigurimet shoqërore	1,415,461	1,388,257
Amortizimi i paisje zyre dhe informatike	1,077,287	1,231,004
Shpenzime telefonie	1,134,008	516,712
Energji elektrike dhe ujë	469,770	513,811
Blerje të ndryshme kancelari	536,544	254,934
Qira zyre	568,481	582,585
Riparim zyre	3,554,017	2,454,317
Karburant	796,659	1,098,841
Shpenzime pritje përcjellje	3,331,656	3,199,267
Siguracione të tjera dhe mjete transporti	293,713	189,579
Shërbime me të tretë juridike dhe konsulence	29,800,916	19,872,264
Shërbim taksi dhe parkim	415,527	422,060
Trajnim stafi	620,944	-
Udhëtim e dietë	14,848,226	3,887,814
Të tjera shpenzime	806,565	3,289,108
Komision banke	675,200	787,247
	<u><b>78,269,271</b></u>	<u><b>57,942,662</b></u>

**19. Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit**

Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura të tjera	466,855	204,266
	<u><b>466,855</b></u>	<u><b>204,266</b></u>

**20. Shpenzime të tjera**

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për antarësime	259,545	679,829
Të tjera	728,481	1,335,225
Gjoha penalitete	1,413,287	4,501,046
	<u><b>2,401,313</b></u>	<u><b>6,516,100</b></u>



## 21. Të ardhura/(shpenzime) financiare neto

Shpenzimet e tjera financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga interesat	22,770,812	8,363,997
Humbje nga këmbimet valutore	(314,680,696)	(11,962,211)
Të ardhura nga këmbimet valutore	8,272,677	54,133,106
	<u>(283,637,207)</u>	<u>50,534,892</u>

## 22. Tatimi mbi fitimin

Përlogaritja e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet si më poshtë :

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	108,553,252	500,855,117
Shpenzime të panjohura	9,695,367	15,831,647
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>118,248,619</u>	<u>516,686,764</u>
<i>Tatim fitimi @15%</i>	(17,737,293)	(77,503,015)
<i>Fitimi neto i vitit</i>	<u>90,815,959</u>	<u>423,352,102</u>
	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Tatim fitimi i parapaguar/ (për t'u paguar) 1 janar	5,917,027	(22,295,139)
Pagesë detyrimi i vitit parardhës	-	25,248,974
Tatim fitimi i parapaguar	66,787,402	80,466,207
Tatim fitimi i kompensuar me TVSH për t'u rimbursuar	6,458,605	-
Tatim fitimi i vitit	(17,737,293)	(77,503,015)
Tatim fitimi i parapaguar/(për t'u paguar)	<u>61,425,741</u>	<u>5,917,027</u>

**23. Transaksionet me palët e lidhura**

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Air BP Greece	-	83,300	-	-
BP International Ltd	-	59,971	-	-
BP Exploration	197,006	-	185,715	-
Air BP Italia	-	6,146,279	-	-
BP Europe	-	7,893,257	-	-
	<b>197,006</b>	<b>14,182,807</b>	<b>185,715</b>	<b>-</b>

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Air BP Greece	-	6,768,916	-	13,118,799
BP Shipping Limited	-	-	-	642,147
BP International Ltd	-	24,507,922	-	16,495,815
Air BP Kosova	1,770,709	-	2,145,236	-
Air BP Ltd	-	34,868,310	-	35,789
BP Exploration	3,261,824	-	3,380,917	-
Air BP Italia	-	6,156,449	-	-
Air BP Croatia	1,193,284	-	-	-
BP Europe	-	7,893,257	-	-
	<b>6,225,817.00</b>	<b>80,194,854</b>	<b>5,526,153</b>	<b>30,292,550</b>

Balancat dhe transaksionet e mësipërme vijnë nga aktiviteti përditshëm i biznesit dhe janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të përafërta me ato të tregut.

**24. Manaxhimi i riskut financiar**

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua dhe llogari të arkëtueshme, dhe mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.



**24. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)****Risku i tregut**

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

**Risku i normave të interesit**

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë nuk mbartin risk të normave të interesit.

**Risku i kreditit**

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Llogari të arkëtueshme	92,864,193	87,778,756
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	197,006	185,715
Llogari të tjera të arkëtueshme	15,179,451	22,170,621
Mjete Monetare	2,118,166,126	2,165,278,948
	<b>2,226,406,776</b>	<b>2,275,414,040</b>

	<b>31 dhjetor 2017</b>	<b>31 dhjetor 2016</b>
Llogari të arkëtueshme me zhvlerësim specifik	93,061,199	87,964,471
Llogari të arkëtueshme me zhvlerësim kolektiv	-	-
	<b>93,061,199</b>	<b>87,964,471</b>

## 24. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

## Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Përshkrimi	31 dhjetor 2017				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	103,229,883		376,299	4,634,468	108,240,650
Mjete monetare në arkë dhe bankë	2,118,166,126				2,118,166,126
<b>Totali</b>	<b>2,221,396,009</b>	-	<b>376,299</b>	<b>4,634,468</b>	<b>2,226,406,776</b>
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(32,681,027)				(32,681,027)
Hua					-
<b>Totali</b>	<b>(32,681,027)</b>	-	-	-	<b>(32,681,027)</b>
<b>Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2017</b>	<b>2,188,714,982</b>	-	<b>376,299</b>	<b>4,634,468</b>	<b>2,193,725,749</b>

Përshkrimi	31 dhjetor 2016				
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	105,475,581		4,659,463		110,135,044
Mjete monetare në arkë dhe bankë	2,165,278,948				2,165,278,948
<b>Totali</b>	<b>2,270,754,529</b>	-	<b>4,659,463</b>	-	<b>2,275,413,992</b>
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(12,337,344)				(12,337,344)
Hua					-
<b>Totali</b>	<b>(12,337,344)</b>	-	-	-	<b>(12,337,344)</b>
<b>Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2016</b>	<b>2,258,417,185</b>	-	<b>4,659,463</b>	-	<b>2,263,076,648</b>



## 24. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

## Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Përshkrimi	31 dhjetor 2017			
	EUR	ALL	USD	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	8,234,038	-	84,827,161	93,061,199
Mjete monetare në arkë dhe bankë	785,840	21,780,090	2,095,600,196	2,118,166,126
<b>Totali</b>	<b>9,019,878</b>	<b>21,780,090</b>	<b>2,180,427,357</b>	<b>2,211,227,325</b>
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	(2,761,974)	(30,598,445)		(33,360,419)
Hua				-
<b>Totali</b>	<b>(2,761,974)</b>	<b>(30,598,445)</b>	<b>-</b>	<b>(33,360,419)</b>
<b>Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2017</b>	<b>6,257,904</b>	<b>(8,818,355)</b>	<b>2,180,427,357</b>	<b>2,177,866,906</b>

Përshkrimi	31 dhjetor 2016			
	EUR	USD	ALL	Total
Llogari tregtare të arkëtueshme dhe të tjera	-	83,119,292	27,015,752	110,135,044
Mjete monetare në arkë dhe bankë	674,529	2,121,798,016	2,806,403	2,165,278,948
<b>Totali</b>	<b>674,529</b>	<b>2,204,917,308</b>	<b>29,822,155</b>	<b>2,275,413,992</b>
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	-	(767,216)	(11,570,128)	(12,337,344)
Hua				-
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>(767,216)</b>	<b>(11,570,128)</b>	<b>(12,337,344)</b>
<b>Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2016</b>	<b>674,529</b>	<b>2,204,150,092</b>	<b>18,252,027</b>	<b>2,263,076,648</b>

## 25. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiarë përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare.

Aktivët financiarë përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

**26. Burimet kryesore në vlerësimin e pasigurisë***Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme*

Një vlerësim i shumës së mbledhshme të llogarive të arkëtueshme tregtare kryhet kur arkëtimi i shumës së plotë nuk është më e mundur. Për shumat individuale të rëndësishme, ky vlerësim është kryer në baza individuale. Shumat të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht, por që janë të vonuara, vlerësohen në mënyrë kolektive dhe aplikohet një provizion në përputhje me gjatësinë e kohës së vonuar, bazuar në normat historike të rikuperimit.

Në datën e raportimit nuk ka ndonjë tregues që llogaritë e arkëtueshme të jenë zhvlerësuar.

**27. Angazhime dhe pasiguri**

Angazhimet per qera operative paraqiten më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Për t'u paguar deri në 1 vit	21,059,280	21,420,432
Për t'u paguar deri në 5 vjet	10,529,640	-
	<u><u>31,588,920</u></u>	<u><u>21,420,432</u></u>

*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

*Detyrimet tatimore*

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

**28. Ngjarje pas datës së raportimit financiar**

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.